



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2108 / Prot

Datë 10/8 2022

VENDIM

Nr. 31, Datë 20.07. 2022

“PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË KURSEVE TË TRAJNIMIT DHE ÇERTIFIKIMIT TË PUNONJËSVE ARSIMORË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS, FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE, FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS”

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar me Urdhërin e MASR Nr. 816 datë 26.12.2018; Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Ligjit Nr. 115 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; Udhëzimit Nr. 16 datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sstemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë; materiali të paraqitur nga Administratori i UT-së:

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së kurseve të trajnimit dhe çertifikimit të punonjësve arsimorë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës”
2. Punonjësit arsimorë trajnohen të paktën 3 ditë në vit dhe trajnimi nënkupton 18 orë trajnimi në vit, të cilat pasqyrojnë 1 kredit.
3. Tarifa për 1 kredit të jetë për shumën 1000 lekë.
4. Tarifa për RASH-in të jetë 100 Euro deri në 100 mësues.
5. Minimumi i formimit të grupit duhet të jetë 15 mësues (punonjës mësimorë).
6. Burimi i financimit për këto kurse trajnimi do të jetë tarifa e kursit për kredit ,dhe pa efekte financiare shtesë nga Buxheti i UT-së.

7. Shpërblimi për orët e trajnimit të personelit akademik të paguhen sipas pagës orare, sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar, si dhe me miratim të Bordit të Administrimit.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Asoc. Dr. Adela KARAPICI

